



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 142/prot.

Tiranë, më 18.11.2025

VENDIM

Nr. 126, Datë 18.11.2025

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ
NDËRMARRJEVE VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË
TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, duke vlerësuar rëndësinë strategjike që ka sektori i telekomunikacioneve për funksionimin e një tregu konkurrues dhe transparent, ka ndërmarrë ndër vite monitorime, hetime dhe ka dhënë një sërë rekomandimesh për rritjen e konkurrencës në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë në tregun e telefonisë së lëvizshme. Këto ndërhyrje kanë synuar liberalizimin e tregut, zbatimin e metodologjive të qarta për rregullimin e tarifave, implementimin e portabilitetit të numrit, përafrimin e kuadrit ligjor me direktivat e Bashkimit Europian, si dhe masat për barazimin e tarifave brenda dhe jashtë rrjetit. Gjithashtu, është rekomanduar garantimin e transparencës përmes publikimit të çmimeve për njësi për çdo shërbim (lekë/min, lekë/SMS, lekë/MB, etj.) të përfshira në paketat standarde.
2. Gjatë vitit 2020, tregu me pakicë i shërbimeve celulare është hetuar nga Autoriteti i Konkurrencës,

dhe Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 703, datë 06.08.2020, ka vendosur mbylljen e procedurës së hetimit paraprak duke miratuar si të detyrueshme angazhimet e propozuara nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, në formën e kushteve dhe detyrimeve përkatëse (angazhime të cilat janë zbatuar nga ndërmarrjet). Për AKEP-in, si autoritet rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, është dhënë një rekomandim specifik në pikën “V” të vendimit, sipas të cilit: “Hedhja në treg e paketave të reja nga çdo ndërmarrje në tregun me pakicë të shërbimeve celulare duhet të shoqërohet me një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasues, në zbatim të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”. Ky rekomandim, deri më sot, nuk është përmbushur nga AKEP.

3. Po ashtu, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1048, datë 16.01.2024, “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me Dokumentin për Këshillim Publik “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)””, ka rekomanduar në pikën “I/i” që: “Në kushtet e ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e telefonisë celulare, AKEP të kryejë analizën e tregut të pakicës, me qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu.” *Edhe ky rekomandim nuk është përmbushur nga AKEP.*
4. Në funksion të rolit të tij si autoritet rregullator, AKEP ka të drejtë ligjore që në rastet kur rezulton se nuk ka konkurrencë efektive në tregun e pakicës, të ndërmarrë masa të posaçme ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg. Në përputhje me Ligjin nr. 54/2024, AKEP mund të vendosë detyrime të tilla si: kërkesa që sipërmarrësit e identifikuar të mos ofrojnë çmime të larta, të cilat pengojnë hyrjen në treg ose kufizojnë konkurrencën, duke vendosur çmime grabitqare, të mos tregojnë preferenca të panevojshme ndaj përdoruesve fundorë specifikë ose shërbime paketë, në mënyrë të paarsyeshme si dhe masa për orientimin e tarifave drejt kostove.
5. Nisur nga disa ankesa të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me rritjen e çmimit të paketave me parapagesë nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA, si dhe nga ankesat e mëvonshme gjatë vitit 2024 në lidhje me ndërmarrjen One Albania SHA, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kreu një monitorim në këtë treg. Monitorimi kishte për qëllim vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA.
6. Sipas raportit vjetor të AKEP për vitin 2023, në seksionin “Dinamika e pjesëve të tregut të shërbimeve celulare”, rezulton se edhe gjatë vitit 2023, Vodafone Albania SHA mbetet operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike celulare. Më konkretisht, pjesët e tregut për vitin 2023 për këtë ndërmarrje janë si në vijim: rreth 47% për përdoruesit e kartave SIM; rreth 51% për përdoruesit aktivë të kartave SIM; rreth 55% për thirrjet dalëse; rreth 54% për volumin e të dhënave (internetit); rreth 56% për përdoruesit aktivë të internetit (broadband); dhe rreth 56% për të ardhurat totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.
7. Për ndërmarrjen One Albania, sipas po të njëjtit raport të AKEP për vitin 2023, treguesit janë si në vijim: rreth 53% për përdoruesit e kartave SIM; rreth 49% për përdoruesit aktivë të kartave SIM; rreth 45% për thirrjet dalëse; rreth 46% për volumin e të dhënave; rreth 44% për përdoruesit aktivë

të internetit (broadband); dhe rreth 44% për të ardhurat totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

8. Sipas kontratës së pajtimit të Vodafone Albania SHA, “Termat dhe Kushtet e Përgjithshme për shërbimet e telefonisë së lëvizshme”, në pikën 5, germa “e”, parashikohet se: detyrimet e pajtimtarit për pagesën e tarifave të përcaktuara në kontratë dhe/ose në listën e tarifave bashkëlidhur, mund t’i nënshtrohen rregullimeve jo më shumë se një herë në vit. Çdo muaj prill (si muaji i aplikimit të ndryshimit), vlera mujore e planit tarifar dhe e çdo pakete do të rritet në përputhje me normën e Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK), të publikuar në muajin janar nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Ky ndryshim është aplikuar duke filluar nga fatura e muajit prill e në vijim.
9. Ndërmarrja One Albania, me shkresën e protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 211/1 prot., datë 13.03.2024, ka njoftuar se ka përditësuar termat dhe kushtet e kontratave për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe celulare, duke përfshirë një klauzolë mbi indeksimin e çmimeve të pajtimtarëve në përputhje me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK), të publikuar zyrtarisht nga INSTAT.
10. Siç evidentohet më sipër, kjo dispozitë në kontratat e pajtimit i ekspozon konsumatorët ndaj një pasigurie dhe paqartësie lidhur me çmimet që do të paguajnë, duke i ngarkuar padrejtësisht me barrën e pasigurisë financiare të shkaktuar nga inflacioni — një rrezik që konsumatorët nuk janë në gjendje ta parashikojnë apo ta kuptojnë plotësisht. Në këtë kontekst, sipas një njoftimi të publikuar nga Ofcom më 19 korrik 2024, thuhet se: “...Nga 17 janari 2025, ofruesve të shërbimeve celulare, internetit dhe TV me pagesë do t’u ndalohej përfshirja e kushteve të rritjes së çmimeve të lidhura me inflacionin në kontrata. Ndërmarrjet BT dhe Vodafone kanë ndryshuar tashmë praktikën e tyre të çmimeve në përgjigje të konsultimit të Ofcom...”.
11. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit, sjellja e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare ngre dyshime për kufizim të konkurrencës, në kuptim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, për periudhën nga 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2024.
12. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1201, datë 25.07.2025 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1156, datë 29.01.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, vendosi për shtyrjen e hetimit paraprak në këtë treg dhe hetimi përfshin periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 25.07.2025.
13. Në zbatim të këtij vendimi, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA, One Albania SHA dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

II. Tregu përkatës

14. Tregu objekt i hetimit është tregu me pakicë i shërbimeve celulare, në të cilin shërbimi përkatës konsiston në ofrimin e aksesit në rrjet dhe të thirrjeve dalëse, përmes paketave të ofruara me parapagim dhe me kontratë nga ndërmarrjet operuese. Ky shërbim është i lëvizshëm, pra i aksesueshëm për përdoruesin në çdo kohë dhe vend, të paktën brenda zonës së mbulimit të operatorit përkatës. Telefonja fikse nuk përfshihet në këtë treg, për shkak të karakteristikave të ndryshme që ka në raport me telefoninë celulare. Nga pikëpamja e përdoruesve, këto dy lloje shërbimesh nuk janë të zëvendësueshme me njëra-tjetrën.
15. Në tregun në shqyrtim veprojnë dy ndërmarrje që ofrojnë shërbime celulare dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të dy nivelet e tregut – si në segmentin me shumicë, ashtu edhe në atë me pakicë. Të dy operatorët janë të integruar vertikalisht dhe ofrojnë gjithashtu shërbimin e terminimit për konkurrentët e tyre.
16. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha shërbimet publike të telefonisë celulare të ofruara nga operatorët në tregun me pakicë.
17. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën ku ndërmarrjet ofrojnë dhe konsumatorët kërkojnë shërbimin, dhe ku kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene. Në rastin konkret, territori ku operatorët celularë zhvillojnë aktivitetin e tyre, në përputhje me licencat përkatëse, është territori i Republikës së Shqipërisë.
18. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës përkufizohet si tregu i shërbimeve publike të telefonisë celulare – që përfshin aksesin në rrjetin celular nga përdoruesit fundorë, si dhe të gjitha llojet e thirrjeve dalëse, SMS-ve dhe aksesit në internet broadband – të ofruara nëpërmjet paketave me parapagim dhe me kontratë nga ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë

III. Pjesët e Tregut

19. Nga vlerësimi i kriterit të pjesëve të tregut rezulton se:
 - Duke vlerësuar treguesit e të ardhurave totale të kompanive për periudhën 2022 - 2024, rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për të me përkatësisht % në vitin 2022, % në vitin 2023, % në vitin 2024 dhe % për 7 muajt e parë të 2025. Ndërkohë, ka zotëruar përkatësisht % në 2022, në 2023, në 2024 dhe % për periudhën janar – korrik 2025
 - Nga pjesët e tregut sipas të ardhurave në retail për periudhën 2022 - 2024, rezulton se ndërmarrja me pjesë për të është me pjesë tregu që nga % (2022), (2023) në % (2024), në vitin 2024. Ndërmarrja tjetër zotëron pjesën tjetër të tregut në vitin 2022, (2023), (2024) dhe % në vitin 2024.
 - Duke vlerësuar kriterin sipas pajtimtarëve me paspagesë (kontratë) në tregun përkatës rezulton se: ndërmarrja ka ruajtur të tregut në këtë segment me në vitet 2022 2023, në vitin 2024 dhe në muajt e parë të 2025. Ndërmarrja ka zotëruar përkatësisht në vitet 2022 dhe % në vitin 2024 dhe në janar – korrik 2025.

- Duke vlerësuar kriterin sipas pajtimtarëve me parapagesë në tregun përkatës rezulton se: Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut është në vitin 2022 me dhe me % në vitin 2023, në vitin 2024 dhe në muajt e 2025.
- Duke vlerësuar kriterin sipas pajtimtarëve me parapagesë, vetëm segmenti i paketave mujore standarde në tregun përkatës rezulton se: ndërmarrja me pjesën të tregut për vitin 2022 është ndërsa Në vitet pasuese, 2023 dhe 2024, zotëron përkatësisht % dhe %. Në 7 muajt e parë të 2025 kalon sërish të këtij segmenti tregu me %.
- Duke vlerësuar kriterin sipas të ardhurave nga shërbimi roaming në tregun përkatës rezulton se: gjatë periudhës 2022–2024, ka mbajtur pjesën të tregut në këtë segment: në 2022, në 2023, në 2024 dhe në janar - korrik 2025. ka zotëruar pjesën tjetër me përkatësisht.
- Bazuar në numrin total të kartave SIM për vitet 2022-2024, (2022), në shtatë muajt e parë të 2025. përkatësisht:
- Sipas kriterit të përdoruesve aktivë me kartë SIM, vihet re se, në vitin 2022, kryeson me ndërsa në vitet 2023 dhe 2024, të
- Numri i thirrjeve dalëse ndjek të njëjtin trend me kartat SIM aktive. Në vitin 2022, zotëron Në vitet 2023 dhe 2024, zotëron për t'u rritur në
- Nga volumi i të dhënave të konsumuara, përdoruesit konsumojnë zotëron % në 2022, në 2023, % në 2024 dhe janar – korrik 2025 zotëron përkatësisht
- Në vitin 2022, zotëron aktivë të internetit ose të tregut, Në vitin 2023 dhe 2024, dhe ndërsa Në periudhën janar – korrik 2025, zotëron dhe

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

20. Në vijim të hetimit AK i është drejtuar ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA duke kërkuar informacionin përkatës.

i. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA

21. Ndërmarrja Vodafone Albania ka dërguar informacionin në formë tabelare mbi emërtimet, çmimet dhe përbërjet e paketave me parapagesë, kontratë dhe roaming në vitin 2023, 2024 dhe janar – korrik 2025 dhe se si kanë ndryshuar gjatë kësaj periudhe hetimore, duke cilësuar datën e ndryshimit, emërtimet, çmimet dhe përbërjet e reja për secilën paketë me parapagesë, kontratë dhe roaming.
22. Gjatë gjithë periudhës hetimore për ndërmarrjen Vodafone Albania SHA, paketa më ekonomike në treg për individë ka qenë Vodafone Basic në vlerë 600 ALL. Kjo paketë, e vlefshme për 30 ditë nga momenti i aktivizimit, ofrohet në treg për klientët me buxhet të ulët. Edhe pse ndërmarrja Vodafone

ka hedhur në treg paketa të reja gjatë periudhës hetimore, Vodafone Basic ka mbetur gjithmonë paketa me vlerën ekonomike më të lirë.

23. Të pyetur mbi afatet e vlefshmërisë së rimbushjeve dhe kohën kur një numër kalon në status pasiv, Vodafone Albania ka vënë në dispozicion afatet e vlefshmërisë si edhe sqarimet përkatëse si në vijim: Një numër i ri Vodafone qëndron aktiv në rrjet për 12 muaj. Pas kalimit të periudhës prej 12 muajsh, statusi i numrit është në varësi të rimbushjes nga ana e pajtimtarit sipas afateve. Data e skadimit të kreditit përcakton kohëzgjatjen e Statusit Aktiv, gjatë të cilit pajtimtari ka mundësi të përdorë të gjitha shërbimet që i përkasin planit të tij tarifar. Nëse pajtimtari nuk e rimbush numrin e tij Vodafone deri në datën e përmendur në mesazhin e regjistruar, numri kalon në Statusin Pasiv. Me kalimin e numrit në statusin pasiv, 24 orë më pas krediti konfiskohet. Megjithatë, pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 3 muaj dhe nëse kryen rimbushje brenda periudhës 3 mujore, numri riaktivizohet. Pajtimtari ka mundësinë për të rimarrë numrin e tij brenda një afati kohor prej 2 vjetesh nga momenti që numri i tij është deaktivizuar.
24. Në lidhje me afatet e vlefshmërisë së rimbushjeve së një numri me parapagesë, Vodafone Albania është shprehur si në vijim: për vlerën e rimbushjes 100 – 499 lekë, vlefshmëria e rimbushjes është 30 ditë; për vlerën e rimbushjes 500 – 999 lekë, vlefshmëria e rimbushjes është 45 ditë; për vlerën e rimbushjes 1000 – 2500 lekë, vlefshmëria e rimbushjes është 60 ditë dhe për vlerën e rimbushjes +2501 lekë, vlefshmëria e rimbushjes është 90 ditë.
25. Ndërmarrja Vodafone Albania SHA nuk ka një metodologji të mirëfilltë për përlllogaritjen e kostove për hedhjen në treg të paketave me parapagesë, kontratë dhe roaming por shprehet se, i bazon vendimet komerciale në analiza të detajuara financiare. Ri-dizenjimi i portofolit të planeve me parapagesë dhe me kontratë ka ardhur në formë organike i bazuar në analizën e faktorëve (i) të brendshëm dhe të jashtëm, (ii) vendas dhe gjeo-politikë; Analiza e kostos së brendshme: investimet në rrjet, blerje/ri-balancim spektri, si dhe në teknologjinë 5G; kushtet makroekonomike të tregut.
26. Si dhe ndërmarrja Vodafone Albania SHA mbi çmimin për njësi të përfshirë në paketat me parapagim, me kontratë dhe roaming është shprehur se, llogaritja e cmimit për njësi është teknikisht dhe ekonomikisht e vështirë për tu zbatuar në praktikë. Në vijim të kësaj përgjigjeje Vodafone Albania sqaron të gjitha arsyet teknike, ekonomike si edhe ligjore, me anë të të cilave vërteton vështirësitë dhe pamundësitë e përlllogaritjes së cmimit për njësi për paketat në fjalë. Vodafone Albania thekson se në përputhje me legjislacionin për telekomunikacionin, praktikat rregullatore kryesisht të BE-së, vendosja e cmimit për njësi për paketat e kombinuara është teknikisht dhe ekonomikisht e pamundur, potencialisht e pasaktë dhe ç'orientuese në mungesë të një metodologjie të unifikuar si edhe jo i detyrueshëm nga kuadri ligjor – rregullator kombëtar për telekomunikacionin.
27. Në fund të periudhave 2022 dhe 2023, ndërmarrja Vodafone Albania SHA rezulton me një neto prej _____) lekë në vitin 2022, ose _____ % e të ardhurave të pa tatuara dhe një neto prej _____) lekë në vitin 2023, ose _____ % e të ardhurave. Kjo edhe si pasojë e _____ me rreth _____ %.

28. Edhe në vitin 2024 kjo ndërmarrje ka realizuar të të ardhurave % dhe të me % që ka çuar në nga % në vitin 2023 në % në vitin 2024.
29. Ndërmarrja Vodafone Albania SHA shprehet se, iniciativa për aplikimin e inflacionit në termat dhe kushtet kontraktore erdhi si direktivë e Vodafone Group për të gjitha tregjet Europiane në vitin 2022 duke marrë parasysh vlerat e larta që kapi ky tregues nxitur nga situata post pandemi. Vodafone Albania bazohet në praktika të ngjashme të Vodafone në tregje të huaja, si p.sh. Anglia e cila është mbështetur në një vendim të Gjykatës Evropiane të vitit 2015, ku aplikimi i një klauzole të tillë nuk përbën shkelje. IÇK nuk është aplikuar për asnjë pajtimtar në vitin 2024, pasi asnjë nuk kishte nënshkruar Termat & Kushtet e Përgjithshme të kontratës që përmbanin versionin përfundimtar të kësaj klauzole përpara muajit Prill 2024.

V. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes One Albania SHA

30. Ndërmarrja One Albania SHA ka dhënë informacion të detajuar mbi paketat me parapagesë, kontratë dhe roaming në vitin 2023, 2024 dhe janar – korrik 2025, dhe si kanë ndryshuar gjatë kësaj periudhe hetimore, të ndarë për segmentin biznes dhe për individë.
31. Gjatë gjithë periudhës hetimore për ndërmarrjen One Albania SHA, paketa më ekonomike në treg për individë ka qenë One Lite, e cila u prezantua më 1 Qershor 2023 pas bashkimit të abonentëve të One Telecommunications dhe Albtelecom. Kjo paketë zëvendësoi paketën Unlimited S me përmbajtje të re dhe emërtim të ri, e cila për të njëjtën vlerë prej 600 ALL ofronte më shumë njësi komunikimi, me përmbajtje prej 500 MB, 100 minuta dhe 100 SMS kombëtare. Megjithatë, kur më 1 Gusht 2024 u përditësuan disa prej paketave të tjera me parapagesë si në përfitime ashtu edhe në çmim, One Lite mbeti e pandryshuar, duke ruajtur të njëjtën vlerë prej 600 ALL dhe vlefshmëri prej 30 ditësh nga momenti i aktivizimit.
32. Ndërmarrja One Albania SHA nuk ka një metodologji të mirëfilltë për përllogaritjen e kostove për hedhjen në treg të paketave me parapagesë, kontratë dhe roaming por shprehet se, bazohet në metodologji të çmimeve të lidhura me inflacionin, ashtu si dhe operatorë të tjerë europianë që veprojnë në industrinë e telekomunikacionit. Për shkak të zhvillimeve globale dhe presioneve inflacioniste në vendet e EU-së dhe në Shqipëri, gjatë 2-3 viteve të fundit One Albania ka përjetuar një rritje të konsiderueshme të çmimeve dhe shtirësim të kushteve të kontratave. Kjo rritje është një pasojë e efektit zinxhir dhe transmetimit të inflacionit në marrëveshjet që One Albania ka me palë të treta, duke çuar në rritjen e kostove krahasuar me periudhën para vitit 2022.
33. Si dhe ndërmarrja One Albania SHA është shprehur se, mbi çmimin për njësi të përfshirë në paketat me parapagim, me kontratë dhe roaming nuk gëzon ekspertizë lidhur me këtë çështje dhe nuk ka një metodologji të certifikuar për këtë qëllim. Ka theksuar gjithashtu se, sipas analizave dhe informacionit nga burime zyrtare si BEREC dhe ITU, ende nuk ka një metodologji apo praktikë të unifikuar për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve të përfshira në një paketë (bundle). Kjo për shkak të kompleksitetit dhe kufizimeve teknike e metodologjike që lidhen me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për këto shërbime.
34. Në lidhje me afatet e vlefshmërisë së rimbushjeve së një numri me parapagesë, One Albania është shprehur si në vijim: Për çdo rimbushje nga 100 Lekë deri në 499 Lekë, vlefshmëria e numrit me

parapagesë shtyhet me 30 ditë nga data e rimbushjes; për çdo rimbushje nga 500 Lekë deri në 1,200 Lekë, vlefshmëria e numrit me parapagesë shtyhet me 45 ditë nga data e rimbushjes; për çdo rimbushje nga 1,200 Lekë deri në 2,000 Lekë, vlefshmëria e numrit me parapagesë shtyhet me 60 ditë nga data e rimbushjes; për çdo rimbushje më të madhe se 2,000 Lekë, vlefshmëria e numrit me parapagesë shtyhet me 180 ditë nga data e rimbushjes.

35. Për sa i përket kalimit të një numri me parapagesë në status pasiv, One Albania është shprehur se cikli i një karte të re SIM me parapagesë është 13 muaj, 12 muaj në status “aktiv” dhe 1 muaj në status “pasiv”. Pas kësaj periudhe, 13 mujore, në rast moskryerje të asnjë rimbushjeje, abonenti kalon në statusin “pezulluar” për një periudhë 180 ditore. Me kryerjen e një rimbushjeje abonenti kalon sërish në status aktiv dhe mund të zgjedhë të aktivizojë lirisht planet tarifore që mund ti përshtaten pa kushte detyrime shtesë.
36. Në fund të periudhave 2022 dhe 2023, ndërmarrja rezulton prej lekë në vitin 2022, e të ardhurave të pa tatuara dhe ato prej lekë në vitin 2023, ardhurave.
37. Në vitin 2024, ka përballuar lekë kosto shitje dhe gjeneruar lekë të ardhura nga klientët. Pra të ardhurat janë nga viti paraardhës dhe shpenzimet duke rezultuar me një normë në dallim nga - në vitin 2022 dhe në 2023.
38. Ndërmarrja One Albania SHA shprehet se në vendimin e saj për aplikimin e indeksimit të çmimeve sipas IÇK-së, i është referuar praktikave të operatorëve evropianë, të siguruara kryesisht nga informacioni në raportet periodike të publikuara nga Cullen International për vitet 2023, 2024 dhe 2025, apo edhe informacioneve nga weblink të tjerë. One Albania vendosi për aplikimin e IÇK-së nga 1 Qershor 2024, vetëm për abonentët biznes në masën jo më shumë se 4.8% duke marrë në referencë normën e publikuar nga INSTAT në muajin janar 2024, dhe duke informuar paraprakisht pajtimtarët 30 ditë përpara aplikimit.

VI. Rregullimi i Tregut

39. Sipas nenit 5 të Ligjit nr. 54/2024, një ndër objektivat rregullatorë të AKEP-it është promovimi i konkurrencës eficiente në ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, faciliteteve e shërbimeve shoqëruese të tyre, përfshirë konkurrencën efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike, përmes investimeve ekonomikisht eficiente në infrastrukturën e re dhe atë ekzistuese.
40. Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 54/2024, AKEP-i bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës në çështje të interesit të përbashkët, në zbatim të legjislacionit në fuqi për konkurrencën në sektorin e komunikimeve elektronike. Në veçanti, në procesin e përcaktimit të tregjeve përkatëse dhe analizat e tyre, AKEP-i konsultohet dhe bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës.
41. Në nenin 142, Ligjit nr. 54/2024 përcaktohet se, ofruesit e shërbimit të aksesit në internet dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, duhet të publikojnë informacionin të disponueshëm për publikun i cili duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i lexueshëm nga pajisje kompjuterike, duke

përfshirë publikimin në faqen e internetit të tij në një format të aksesueshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara, informacion i cili ndër të tjera duhet të përmbajë përshkrimin e shërbimeve të ofruara; tarifat e shërbimeve të ofruara; kushtet standarde të kontratës; të përfshijë mundësinë për të krahasuar çmimet, tarifat dhe cilësinë e performancës së shërbimit midis ofertave të disponueshme për përdoruesit fundorë etj.

42. Gjithashtu në vijim të nenit më sipër, pika 5, AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë të kenë akses pa pagesë në të paktën një instrument të pavarur krahasimi, i cili u mundëson atyre krahasimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ndryshme të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, të bazuar në numra të disponueshëm për publikun dhe, sipas rastit, shërbimin e komunikimit ndërpersonal, të disponueshëm për publikun, të pavarur nga numrat, në lidhje me:
- a) çmimet dhe tarifat e shërbimeve të ofruara kundrejt pagesave monetare direkte, periodike ose për njësi të konsumuar;
 - b) cilësinë e performancës së shërbimit në rastet kur garantohej një nivel minimal i cilësisë së shërbimit ose kur sipërmarrësi ka detyrim të publikojë këtë informacion në përputhje me nenin 143 të këtij ligji.

43. Në bazë të nenit 8 të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”:
- sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi tarifat e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre me arsyetimet mbështetese, jo më vonë se 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave ose ndryshimeve të tyre.
 - Ky informacion duhet të dërgohet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore. Forma e dërgimit të të dhënave në rrugë elektronike do të jetë e disponueshme edhe në faqen e internetit të AKEP.
 - AKEP-i publikon vlerësimin e përgjithshëm krahasues të tarifave aktuale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje.
 - Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftojnë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifat e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet jo më pak se 3 ditë rresht;
 - Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t’ia paraqesin ato AKEP-it për vlerësim, të paktën, 15 ditë para publikimit sipas nenit 98 pika 5 të Ligjit.
 - Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të njoftojnë pajtimtarët për çdo modifikim në kushtet e kontratave për jo më pak se 30 ditë përpara në përputhje me nenin 99 pika 3 të Ligjit.

44. AKEP, në faqen zyrtare publikon dokumentin “Vlerësimin e Përgjithshëm Krahasues të Tarifave Aktuale me titull “Tarifat e shërbimit nga rrjete celulare në Shqipëri”.

Sipas këtij dokumenti, në të jepen tabelat që i referohen dy operatotrëve: Vodafone Albania; dhe One Albania, dhe që përmbajnë komponentët e mëposhtëm:

1. Përmbledhje e paketave standarte;
2. Tarifat standarte për shërbimin celular;
3. Planet tarifore, paketat dhe ofertat.

Këto tabela, në lidhje me këto tre komponentë, në vlerësimin e AK nuk shoqërohen nga një analizë dhe vlerësim i përgjithshëm krahasues i tarifave aktuale, sipas përcaktimeve të nenit 8 dhe 12 të Rregullores

nr. 27/2012“ Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

45. Po ashtu në nenin 12, të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, citohet se: “AKEP, analizon dhe bën vlerësimin e përgjithshëm të tarifave aktuale, të disponueshme për publikun me qëllim publikimin e tyre në një seksion të vecantë në faqen elektronike të tij. Për publikimin e tarifave, AKEP udhëhiqet nga parimet themelore që janë: ligjshmëria, transparenca, mosdiskriminimi dhe profesionalizmi”.
46. Për sa më sipër, AKEP në dokumentin e publikuar në faqen zyrtare, sipas vlerësimit të AK nuk ka realizuar një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasues për ndryshimet e kryera në paketat standarde nga tre operatorë celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
47. Referuar nenit 99, pika 1 të Ligjit nr. 54/2024, në përputhje me nenin 92 të këtij ligji, kur pas kryerjes së analizës së tregut AKEP-i evidenton se në treg mungon konkurrenca efektive, që nënkupton se sipërmarrësi i shpallur me fuqi të ndjeshme në treg ka aplikuar tarifa të larta të paarsyeshme ose tarifa të ulëta të paarsyeshme, në dëm të përdoruesve fundorë, AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin në lidhje me mbulimin e kostove dhe kontrollin e çmimeve, duke përfshirë detyrimet për orientimin e çmimeve drejt kostos, si dhe në lidhje me sistemin e mbajtjes së llogarive për ofrimin e llojeve të veçanta të aksesit ose interkoneksionit.
48. Neni 109, pika 1, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr. 54/2024 “Kontrolli rregullator i shërbimeve të shitjes me pakicë”, shpjegon se,
- i. AKEP-i vendos detyrime rregullatore për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, në një treg përkatës me pakicë, në përputhje me këtë ligj kur:
 - a) nëse nga rezultatet e një analize tregu, të kryer në përputhje me nenin 90 të këtij ligji, AKEP-i përcakton se një treg i caktuar me pakicë, i identifikuar në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, nuk është në konkurrencë efektive;
 - b) AKEP-i arrin në përfundimin se detyrimet e vendosura sipas neneve 93 deri në 99 të këtij ligji, për tregun e lidhur me shumicë nuk çojnë në arritjen e objektivave të nenit 5 të këtij ligji.
 - ii. Detyrimet e vendosura sipas pikës 1 të këtij neni bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale dhe të justifikuara për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji. Detyrimet e vendosura përfshijnë kërkesa që sipërmarrësit e identifikuar të mos ofrojnë çmime të larta, të cilat pengojnë hyrjen në treg ose kufizojnë konkurrencën, duke vendosur çmime grabitqare, të mos tregojnë preferenca të panevojshme ndaj përdoruesve fundorë specifikë ose shërbime paketë, në mënyrë të paarsyeshme. AKEP-i zbaton ndaj këtyre sipërmarrësve masat e duhura të kufirit të çmimit të shitjes me pakicë, masat për të kontrolluar tarifatat individuale ose masat për orientimin e tarifave drejt kostove ose çmimeve në tregje të krahasueshme për të mbrojtur interesat e përdoruesve fundorë dhe për të nxitur konkurrencën efektive.
 - iii. AKEP-i siguron që, kur një sipërmarrës i nënshtrohet rregullimit të tarifave me pakicë ose rregullimeve të tjera përkatëse të shitjes me pakicë, zbatohen sistemet e nevojshme dhe të përshtatshme të kontabilitetit të kostos. AKEP-i specifikon formatin dhe metodologjinë e

kontabilitetit që përdoret. Pajtueshmëria me sistemin e kontabilitetit të kostos verifikohet nga një organ i pavarur i kualifikuar. AKEP-i siguron që çdo vit të publikohet një deklaratë në lidhje me pajtueshmërinë.

49. AKEP në dokumentin e publikuar në faqen zyrtare, sipas vlerësimit të AK nuk ka realizuar një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasues për ndryshimet e kryera në paketat standarde nga tre operatorë celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
50. Tregu me pakicë i shërbimeve celulare në Shqipëri paraqitet si një duopol, ku dy operatorët në fjalë zotërojnë së bashku 100% të tregut. Kjo strukturë tregon një koncentrim të lartë tregu dhe një nivel të kufizuar konkurrence efektive, duke krijuar kushte të favorshme për pozitë dominuese kolektive në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
51. Gjatë periudhës hetimore nga 1 janar 2022 deri më 25 korrik 2025, është konstatuar se ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA kanë ndjekur një sjellje të ngjashme tregtare në lidhje me ofertat e tyre të shërbimeve celulare, përfshirë paketat me parapagesë, me kontratë dhe shërbimet roaming. Në këtë periudhë vihet re një rritje progresive dhe pothuajse e sinkronizuar e çmimeve, ndërkohë që nuk rezulton që këto ndërmarrje të kenë përdorur një metodologji të përlogaritjes së kostove, që do të justifikonte ndryshimet e çmimeve të aplikueshme në treg.
52. Nga analiza e zhvillimeve të çmimeve rezulton se, sa herë një nga operatorët ka rritur çmimet e paketave celulare, operatori tjetër e ka ndjekur brenda një periudhe të shkurtër kohore me një rritje të ngjashme, si në nivel çmimi, ashtu edhe në strukturën e paketës (minuta, internet, SMS, vlefshmëri etj.). Kjo tregon një reagim të menjëhershëm dhe simetrik që mund të interpretohet si praktikë e bashkërenduar në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.
53. Analiza e ofertave tregon se paketat e ofruara janë pothuajse identike në çmim dhe përmbajtje (sasi interneti, minuta kombëtare, përfshirje roaming etj.), duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e zgjedhjes për konsumatorët dhe duke reduktuar presionin konkurrues ndërmjet operatorëve. Ky homogjenitet i produkteve, i kombinuar me mungesën e transparencës në kosto, përbën një rrezik për koordinim të sjelljes së ndërmarrjeve, që synon ruajtjen e një niveli të qëndrueshëm çmimesh dhe fitimesh në treg.
54. Asnjë nga ndërmarrjet nuk ka paraqitur dokumentacion që të dëshmojë se çmimet janë përlogaritur mbi bazën e një analize të kostove reale të shërbimeve. Në mungesë të një metodologjie të qartë, rritjet e çmimeve mund të konsiderohen si të pajustificuara ekonomikisht dhe si rezultat i një sjelljeje të orientuar drejt ndjekjes së një modeli të përbashkët tregtar, më shumë sesa drejt konkurrencës përmes inovacionit apo eficiencës.
55. Në konkluzion, në kushtet kur: tregu paraqet strukturë duopolistike; vihet re një sinkronizim në rritjen e çmimeve dhe oferta pothuajse të njëjta në çmime dhe përmbajtje; mungon transparenca dhe metodologjia kosto-çmim, atëherë sjellja e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 18 nëntor 2025.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA () Zv/Kryetar	Rezana KONOMI () Anëtar	Durim KRAJA () Anëtar	Fatjola DELIJA () Anëtar
---	---	--	--

Denar BIBA
()
Kryetar

